



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 79, Datë 02.05.2024

MBI

**KËRKESËN E SHOQWRISË FTL SH.A. PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES
ME SHOQËRINË DRAGOBIA ENERGY SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20 gërmat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 23 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 03.09.2016; nenit 11 të Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.05.2024, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Grupi i Punës me nr. 371/26 prot., datë 30.04.2024 “Mbi kërkesën e shoqërisë FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k.”,

Konstatoi se:

- Shoqëria FTL sh.a. nëpërmjet shkresës nr. 371/24 prot., datë 16.04.2024 ka paraqitur kërkesën për zgjidhje të mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. ku në mënyrë të përmbledhur ndër të tjera parashtron se: “Në kushtet e përcjelljes së planifikimit të prodhimit vjetor jashtë afatit kontraktor, njoftimi i datës 11.12.2023 dhe planifikimi vjetor i përcjellë nga kjo shoqëri nuk është marrë në konsideratë... Në këtë njoftim është deklaruar se një pjesë e sasisë së energjisë elektrike të prodhuar për periudhën 01.02.2024-31.12.2024, do të shitej në ALPEX”.
- Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. nëpërmjet shkresës nr. 371/21 prot., datë 08.04.2024 ndër të tjera ka parashtruar se: *Dragobia Energy sh.p.k. nuk është në shkelje të kontratës dhe është në përmbushje të çdo detyrimi kontraktor apo të çdo akti ligjor dhe nënligjor të sektorit të energjisë elektrike.*

- Në nenin 24 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, “Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga ERE”, përcaktohet ndër të tjera se: *ERE vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura midis të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave. Çdo palë e interesuar, që ka ankesa ndaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, si dhe ndaj të licencuarve të tjerë, lidhur me zbatimin e detyrimeve të tyre, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji apo akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, mund t’i paraqesë për zgjidhje pranë ERE-s.*
- Në këto rrethana sqarojmë se: Shoqëria “Dragobia Energy” sh.p.k. është licencuar nga ERE me vendimin nr. 17, datë 16.02.2016, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hece-t "Ceremi" dhe "Dragobia", sipas përcaktimit në licencën e dhënë nga ERE, si dhe shoqëria FTL sh.a. është licencuar nga ERE për aktivitetin e furnizimit me energji elektrike dhe mban licencën seria 423-F18/F23, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 199 datë 03.09.2018, dhe rinovuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 121, datë 04.04.2023.
- Duke qënë se palët (i) FTL sh.a. dhe shoqëria (ii) Dragobia Energy sh.p.k., janë shoqëri të licencuara në sektorin e energjisë elektrike dhe ngrenë një problematikë për zgjidhje mosmarrëveshje duke mbajtur qëndrime të kundërta në lidhje me njoftimin e kontratës së shitjes së energjisë elektrike, ERE në mbështetje të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, si dhe të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.07.2016, vlerësohet se palët legjitimohen për të kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s:

Vendosi:

1. Pranimin për shqyrtim nga ERE të kërkesës së paraqitur nga shoqëria FTL sh.a. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “Dragobia Energy” sh.p.k. duke filluar procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 114, datë 08.7.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI